



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

		REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA			
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE		DREJTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU			
Nr./No.:		121			
Data/Date:		29.04.2022			
		KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE			

Datë: 29.04.2022

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 28.04.2022, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 336, të datës 15.04.2022, paraqitur nga Drejtoria e Arsimit, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (d), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 5, shkronja (d) të Ligjit për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-068, (Gazeta Zyrtare Nr.30/2008), nenin 20, të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-032, (Gazeta Zyrtare Nr. 17/2011), nenin 6 paragrafi 1, 2, 3 dhe nënparagrafët 3.1, 3.2 dhe 3.3, të Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit Nr. 151/2020 për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe zëvendës drejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar në Republikën e Kosovës, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm, nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (n), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (ç), nenin 27, shkronja (nj) të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, nenin 48, paragrafi 8, të Rregullores për Organizimin Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Organeve të Administratës Komunale nr. 125, të datës 25.09.2014 mori:

V E N D I M

Për zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit për rekrutimin e Zëvendës drejtorit të Shkollës

1. Për zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit për rekrutimin e Zëvendës drejtorit të Shkollës Filllore të Mesme të Ulët 'Mihal Grameno', Aneksi II, në Komunën e Fushë-Kosovës.
2. Për konkursin e Shkollës Filllore të Mesme të Ulët 'Mihal Grameno', Aneksi II, në Komunën e Fushë-Kosovës në përbërje prej tre anëtarëve si vijon:
 - 2.1 Ismet Gashi - Kryetar i Komisionit drejtor në Shollën Filllore të Mesme të Ulët 'Mihal Grameno' në Fushë-Kosovë;
 - 2.2 Miranda Sulejmani - anëtare e Komisionit, përfaqësuese e Drejtorisë Komunale të Arsimit;
 - 2.3 Përfaqësuesi nga Ministria e Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit, anëtar i Komisionit.
 - 2.4 Nexhat Limoni - në cilësinë e vëzhguesit dhe
 - 2.5 Faruk Foniqi - në cilësinë e vëzhguesit.
3. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë së Arsimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së Arsimit, Anëtarëve të Komisionit dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Ali Ismaili





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



		REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE DIREKTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU		
Nr.faq/Br.str.		127		
Data/Datum.		10-05-2022		
		KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE		

Datë: 04.05.2022

Kuvendi i Komunës pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 206, të datës 15.04.2022, në mbledhjen e mbajtur të datës 28.04.2022 aprovon: Raportin financiar për buxhetin e shpenzuar për vitin 2021, të paraqitur për shqyrtim nga Drejtoria e Financave dhe Buxhetit, të shqyrtuar edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë e Financa, bazuar në nenin 11, nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (c, l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 46, paragrafi 46.2, të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë Nr. 03/L-048, (Gazeta Zyrtare 27/2008), nenin 27, shkronja (ç, nj), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, nenin 25, paragrafi 4, nenin 27, paragrafi 2, të Rregullores për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Organeve të Administratës Komunale Nr. 125, të datës 25.09.2014, mori:

V E N D I M

Për aprovimin e buxhetit të shpenzuar në Komunën e Fushë-Kosovës për periudhën janar-dhjetor të vitit 2021

1. Për aprovimin e Raportit Financiar për buxhetin e shpenzuar në Komunën e Fushë-Kosovës, për periudhën janar-dhjetor të vitit të 2021, në shumë të përgjithshme prej 11,330,647.54€.
2. Buxheti i shpenzuar sipas programeve është si vijon:
 - 2.1 Në administratën komunale, buxheti i shpenzuar është në shumë prej 4,585,115.02€;
 - 2.2 Në arsim, buxheti i shpenzuar është në shumë prej 4,759,884.89€;
 - 2.3 Në shëndetësi dhe Qendrën për Punë Sociale, buxheti i shpenzuar është në shumë prej 1,956,188.66€;
 - 2.4 Në Zyrën e Komuniteteve, buxheti i shpenzuar është në shumë prej 29,458.97€.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Financave dhe Buxhetit.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së FB dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës


Ali Ismaili





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 04.05.2022

Kuvendi i Komunës pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 356, të datës 15.04.2022, në mbledhjen e mbajtur të datës 28.04.2022, të paraqitur për shqyrtim nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.1, paragrafi 12.2, shkronja (d), nenin 24.2, nenin 40, paragrafi 40.1, paragrafi 40.2, shkronja (g, l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 2, nenin 8 nenin 10, të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr. 03/L-049, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, shkronja (f, nj), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, nenin 30, paragrafi 1, nenin 31, paragrafët 1, 2, 5 dhe 6 të Rregullores për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Organeve të Administratës Komunale Nr. 125, të datës 25.09.2014, mori:

V E N D I M

Për aprovimin e Propozimit Nr. 356, të datës 15.04.2022, për faljen e borxheve nga taksa komunale, për ushtrimin e veprimtarisë ekonomike për subjektet afariste të Komunës së Fushë-Kosovës

1. Për aprovimin e Propozimit Nr. 356, të datës 15.04.2022, për faljen e borxheve të vjetëruara - obligimeve të krijuara nga taksat komunale për ushtrimin e veprimtarisë ekonomike, për të gjitha subjektet afariste të regjistruara në Komunën e Fushë-Kosovës, përkatësisht 1035 subjekte afariste, në shumë të përgjithshme të mjeteve financiare prej: 782,408.00€ (shtatë qind e tetëdhjetë e dy mijë e katër qind e tetë euro), për periudhën kohore nga viti 2009 deri në vitin 2016.
2. Për zbatimin e këtij vendimi, do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së ZHE dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës


Ali Ismaili





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 04.05.2022

Kuvendi i Komunës pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 327, të datës 14.04.2022, në mbledhjen e mbajtur të datës 28.04.2022, të paraqitur për shqyrtim nga Drejtoria e Gjeodezisë Kadastrit dhe Pronës, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (d), nenin 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (ç), nenin 27, të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për aprovimin e Propozimit për caktimin e lokacionit për vendosjen e shtatores së heroit Hysen Zogjani në Fushë-Kosovës

1. Për aprovimin e Propozimit për caktimin e lokacionit për vendosjen dhe ndërtimin, e shtatores së heroit Hysen Zogjani në rrugën 'Dëshmorët e Lirisë', në hapësirën 4 x 4 metra në ngastrën kadastrale Nr. P-72514036-00837-0, të evidentuar në certifikatën e pronës me datën 05.04.2022, psh. rrugë, e paketegorizuar, në Zonën Kadastrale në Fushë-Kosovë.
2. Për zbatimin e këtij vendimi, do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Gjeodezisë Kadastrit dhe Pronës, në kordinim të përbashkët me Agjensinë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së GJKP dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës


Ali Ismaili





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 04.05.2022

Kuvendi i Komunës pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 340, të datës 15.04.2022, në mbledhjen e mbajtur të datës 28.04.2022, të paraqitur për shqyrtim nga Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, bazuar në nenin 11, nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, shkronja (nj), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për aprovimin e Propozimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Palestrës së Gjimnastikës në fshatin Miradi e Poshtme

1. Për aprovimin e Propozimit për caktimin e lokacionit, për ndërtimin e Palestrës së Gjimnastikës në fshatin Miradi e Poshtme, në ngastrën kadastrale Nr. P-72514027-00196-1, psh. fshati në Zonën Kadastrale Miradi e Poshtme, sipas certifikatës së pronës të lëshuar me datën 05.05.2022, nga kadastru dhe specifikimin e grafikës për pronën në gjeodezi për lokacionin me Nr. P-72514027-00196.
2. Palestra e Gjimnastikës do të ndërtohet sipas 'Marrëveshjes ndërmjet Komunës së Fushë-Kosovës Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sporteve dhe Federatës Ndërkombëtare të Gjimnastikës'.
3. Për zbatimin e këtij vendimi, do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Kulturës Rinisë së Sporteve.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së KRS dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës


Ali Ismaili





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 04.05.2022

Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur të datës 28.04.2022, pas shqyrtimit të Kërkesës DL Nr. 1140-2/22, të datës 25.03.2022, të Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe shkresës së Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal Nr. VI – 020 - 239/13, të datës 25.03.2022, për rishqyrtimin e vendimit Nr. 58, të datës 07.03.2022, bazuar në nenin 11, nenin 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Nr. 58, i datës 07.03.2022 për bonuset e zonimit për ndërtime në Fushë-Kosovë

1. Vendimi Nr. 58, i datës 07.03.2022, për bonuset e zonimit për ndërtime në Fushë-Kosovë, mbetet në fuqi, pas rishqyrtimit të Kërkesës DL Nr. 1140-2/22, të datës 25.03.2022, të Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe shkresës përcjellëse të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal Nr. VI - 020 - 239/13, të datës 25.03.2022.
2. Kuvendi i Komunës rekomandon që Ekzekutivi i Komunës, respektivisht Drejtoria e Planifikimit Urban, në kordinim dhe ndërlidhje të punës dhe veprimeve me Ministrinë e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, të harmonizon kërkesat për rishqyrtim lidhur me bonuset e zonimit për ndërtime në Fushë-Kosovë, sipas Kërkesës DL Nr. 1140-2/22, të datës 25.03.2022, të Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, për hartimin e aktit të përgjithshëm, për bonuset e zonimit sipas legjislacionit në fuqi, për dokumentet e planifikimit hapësinorë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së PU dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës


Ali Ismaili





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 02.03.2022

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 28.02.2022, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 121, të datës 16.02.2022, paraqitur nga Drejtoria e Financave dhe Buxhetit, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa, bazuar në nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (d), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (c), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 8 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr. 03/L-049, (Gazeta Zyrtare Nr. 27/2008), nenin 27 të Ligjit 03/L-048, për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (ç), nenin 27, shkronja (ç) dhe nenin 54 të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Lejohet bartja e mjeteve financiare të pa shpenzuara nga të hyrat vetjake të vitit fiskal 2021 në vitin fiskal 2022

1. Lejohet bartja e mjeteve financiare të pa shpenzuara nga të hyrat vetjake të vitit fiskal 2021, në vitin fiskal 2022 në shumë të përgjithshme prej 5,007,507.41€, sipas propozimit me dokumentin financiar të Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit me Nr. 121, të datës 16.02.2022.
2. Bartja e mjeteve financiare nga të hyrave vetjake të pa shpenzuara është për kategoritë ekonomike të shpenzimeve si vijon:
 - 2.1 Për kategorinë ekonomike paga dhe mëditje shuma e përgjithshme e mjeteve financiare është 369,650.92€;
 - 2.2 Për kategorinë ekonomike mallra e shërbime shuma e përgjithshme e mjeteve financiare është 1,019,085.25€;
 - 2.3 Për kategorinë ekonomike subvencione shuma e përgjithshme e mjeteve financiare është 775,110.68€;
 - 2.4 Për kategorinë ekonomike investime kapitale shuma e përgjithshme e mjeteve financiare është 2,843,660.56€.
3. Shpërndarja e mjeteve financiare të bartura sipas përshkrimit bazik në pikën një dhe dy të vendimit është e detajizuar dhe e përshkruar, për secilin shpenzim në dokumentin financiar që është pjesë e këtij vendimi.
4. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë për Financa dhe Buxhet.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës dhe shfuqizon vendimin Nr. 12, të datës 02.02.2022.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së FB, Drejtorive tjera të Komunës dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Ali Ismaili



Merita Krasniqi

From: Gëzim Paci
Sent: Tuesday, February 8, 2022 2:32 PM
To: Ramadan Jashanica; Bardhyl Koiçiçi
Cc: Merita Krasniqi; Jeton M. Gashi
Subject: Kërkesa për bartjen e THV të vitit 2021 në vitin aktual

Përshëndetje të nderuar,

Departamenti i Buxhetit, MFPT ka pranuar kërkesën nga komuna e Fushë Kosovës me nr.158/2021 të datës 04.02.2022 për bartjen e të hyrave vetanake të vitit 2021 në vitin 2022, në vlerë: 5,007,507.41 Euro.

Fillimisht, ju informoj që kërkesa juaj do të shqyrtohet vetëm pas publikimit të Raportit vjetor financiar për vitin 2021 nga Departamenti i Thesarit (përmes së cilit, do të kemi gjendjen e saktë të të gjitha të hyrave dhe shpenzimeve për vitin paraprak).

Gjithashtu, kërkesës suaj për bartje të të hyrave vetanake duhet t'i bashkëngjisni edhe arsyeshmërinë ekonomike. Ndërsa, lidhur me shpenzimet kapitale të propozuara për financim nga kjo kërkesë, ju informoj, që disa prej tyre nuk i plotësojnë kriteret e parapara për projekte kapitale sipas UA MF-04/2019 dhe MF-06/2019 (dhe të cilat kanë kaluar në kategorinë e rezervës edhe gjatë dorëzimit të projektbuxhetit për vitin 2022 nga komuna juaj, si rezultat i klasifikimit jo të duhur), si më poshtë:

- Pagesa për vendime gjyqësore kompensim për palët e dëmtuara në rastet e vendosura nga gjykatat – 369,650.92 Euro;
- Rastet emergjente – 295,391.65 Euro;
- Pastrimi sanitar i pyjeve – 15,000 Euro;
- Hartimi i planit të mobilitetit dhe projekteve ideore – 74,000 Euro;
- Ndërtimi i shtëpive për raste sociale – 156,567.46 Euro;
- Renovimi i shtëpive për raste sociale – 109,774.53 Euro;
- Mirëmbajtja e objekteve shëndetësore – 23,086.89 Euro;
- Ndërtimi i dy shtatoreve "Ibrahim Rugova" dhe "Adem Jashari" – 107,161.19 Euro (specifikim i pronësisë pas përfundimit të projektit).

Me qëllim të shqyrtimit të kërkesës suaj, ju rekomandoj, të bëni klasifikimin e duhur të këtyre projekteve sipas kategorive adekuate të shpenzimeve.

Gjithë të mirat,

Gëzim Paci

Analist i Lartë i Buxhetit
Departamenti i Buxhetit

Bartja e mjeteve të pasqepnuara nga viti 2021 në vitin 2022

Komuna: FUSHË KOSOVËS						
Nën/Programi	Kodi i nën-programit	Kodi Funkcional	Fondi Burimor	Kategoria ekonomike	Pershkrimi i nënzerit	BARTJA 2022
ADMINISTRATA - FUSHË KOSOVË	16302	0133	22	11	PAGA DHE SHITESA	169,650.92
ADMINISTRATA - FUSHË KOSOVË - ARSIM	92010	0980	22	11	PAGA DHE SHITESA	100,000.00
ADMINISTRATA SHËNDETËSI - FUSHË KOSOVË	73011	0760	22	11	PAGA DHE SHITESA	100,000.00
Paga dhe medijtje						369,650.92
INFRASTRUKTURA PUBLIKE - FUSHË KOSOVË	18162	0451	22	13	MALLRA DHE SHËRBIME	285,391.65
ADMINISTRATA SHËNDETËSI - FUSHË KOSOVË	73011	0760	22	13	MALLRA DHE SHËRBIME	23,066.89
SHËRBIMET E KUJDESIT PRIMAR SHËNDETËSOR - FUSHË KOSOVË	73150	0721	22	13	MALLRA DHE SHËRBIME	309,017.65
ADMINISTRATA - FUSHË KOSOVË - ARSIM	92010	0980	22	13	MALLRA DHE SHËRBIME	204,427.87
ZHVILLIM RURAL DHE INSPEKSIONI I BUJQËSISË - FUSHË KOSOVË	47042	0421	22	13	MALLRA DHE SHËRBIME	15,000.00
PLANIFIKIMI HAPSIOR DHE RREGULLATIV - FUSHË KOSOVË	66015	0820	22	13	MALLRA DHE SHËRBIME	74,000.00
SHËRBIMET KULTURORE - FUSHË KOSOVË	85002	0820	22	13	MALLRA DHE SHËRBIME	107,161.19
Mallera dhe shërbime						1,019,035.25
				14	SHIPENZIME KOMUNALE	0.00
Komunalit						0.00
ZYRA E KRYETARIT - FUSHË KOSOVË	16002	0111	22	20	SUBVENCIONET DHE TRANSFERET	13,685.00
ZHVILLIMI RURAL DHE INSPEKSIONI I BUJQËSISË - FUSHË KOSOVË	47042	0421	22	20	SUBVENCIONET DHE TRANSFERET	231,369.32
ADMINISTRATA - FUSHË KOSOVË-SHËNDETËSI	73011	0760	22	20	SUBVENCIONET DHE TRANSFERET	280,000.00
SHËRBIMET KULTURORE - FUSHË KOSOVË	85002	0820	22	20	SUBVENCIONET DHE TRANSFERET	140,400.00
ADMINISTRATA - FUSHË KOSOVË-ARSIM	92010	0980	22	20	SUBVENCIONET DHE TRANSFERET	109,665.36
Subvencione						775,110.68
			22	30	INVESTIMET KAPITALE	2,843,660.56
Kapitale						2,843,660.56
TOTALI : FUSHË KOSOVË						5,007,507.41



Bartja e mjeteve të pasqyruara nga viti 2021 në vitin 2022

Komuna: FUSHË KOSOVË

Programi	Kodi i unit programit	Kodi funksional	Fondi Burimor	Kategoria ekonomike	Kodi i projektit	Pershkrimi i nencrit	BARTJA 2020
Administrata - Fushe Kosove	16302	133	22	30	46263	Blerja e Kompjuterave	10,000.00
Administrata - Fushe Kosove	16302	133	22	30	49169	Blerja e Veturave	150,000.00
Administrata - Fushe Kosove	16302	133	22	30	49315	Dijshjalizimi i calles se Kuvendit Komunal ne Fushe Kosove	10,000.00
Budjeti - Fushe Kosove	17502	112	22	30	44684	Bankfinancimi i Projekteve	1,237.58
Infrastruktura Publike - Fushe Kosove	18162	451	22	30	44693	Ndertimi i rruges me zhavor	151,726.05
Infrastruktura Publike - Fushe Kosove	18162	451	22	30	44697	Vendosja e Ndrigimit publik dhe nirendbajta e tyre	34,427.48
Infrastruktura Publike - Fushe Kosove	18162	451	22	30	44699	Rregullimi i parkut ne pisha te silatiner se vogel	219,496.46
Infrastruktura Publike - Fushe Kosove	18162	451	22	30	44701	Shenj Horiz/Verti RR Pastrimi i Serezmit Dimeror dhe vror	207,913.80
Infrastruktura Publike - Fushe Kosove	18162	451	22	30	49363	Rregullimi i sheshit ne Lagjen Dardania	147,758.27
Infrastruktura Publike - Fushe Kosove	18162	451	22	30	49420	Ndertimi i urave,shtratit te humentjeve,liqenave ,perroitkave etj	71,898.30
Infrastruktura Publike - Fushe Kosove	18162	451	22	30	50006	Ndertimi i parqeve,tronareve ,kendi lojtrave dhe nibejlla e pemave dekorative	71,316.25
Zhvillimi Rural dhe Inspekcioni i Dajqesise-Fushe Kosove	47042	421	22	30	44677	Pyllezimi i ciperfaqeve te zhveshura	15,000.00
Planifikimi Hapesinor dhe rregullativ - Fushe Kosove	66015	620	22	30	49752	Ndertimi i kanalizimit dhe ujexjellesit (Fshata,Qvitet)	115,456.54
Planifikimi Hapesinor dhe rregullativ - Fushe Kosove	66015	620	22	30	44776	Asfaltimi ne Fushe Kosove	48,494.85
Planifikimi Hapesinor dhe rregullativ - Fushe Kosove	66015	620	22	30	49137	Asfaltimi ne Grabove	12,718.00
Planifikimi Hapesinor dhe rregullativ - Fushe Kosove	66015	620	22	30	44786	Asfaltimi ne Silatin e vogel	12,194.40
Planifikimi Hapesinor dhe rregullativ - Fushe Kosove	66015	620	22	30	44788	Asfaltimi ne Miradi te Eperme	30,850.09
Planifikimi Hapesinor dhe rregullativ - Fushe Kosove	66015	620	22	30	50764	Asfaltimi i rruges-Anticart e Goleshit	103,950.00
Planifikimi Hapesinor dhe rregullativ - Fushe Kosove	66015	620	22	30	89201	Asfaltimi ne Harilaq	8,756.92
Planifikimi Hapesinor dhe rregullativ - Fushe Kosove	66015	620	22	30	89202	Asfaltimi ne Hene	7,176.60
Planifikimi Hapesinor dhe rregullativ - Fushe Kosove	66015	620	22	30	49135	Asfaltimi ne Miradi te Poshtme	16,914.00
Planifikimi Hapesinor dhe rregullativ - Fushe Kosove	66015	620	22	30	46251	Asfaltimi Ponorozin	11,340.59
Planifikimi Hapesinor dhe rregullativ - Fushe Kosove	66015	620	22	30	40114	Asfaltimi ne Vragoli	17,730.00
Planifikimi Hapesinor dhe rregullativ - Fushe Kosove	66015	620	22	30	89195	Asfaltimi ne Bandi te noda	41,152.03
Sherbimet Kulturore - Fushe Kosove	85002	820	22	30	48721	Ndertimi i fushave te sportit dhe stales	112,745.44
Sherbimet Kulturore - Fushe Kosove	85002	820	22	30	49796	Ndertimi i sallave te sportit tek objektet shkollore	180,000.00
Sherbimet Kulturore - Fushe Kosove	85002	820	22	30	50774	Ndertimi i calles se pjimastikes ne Fushe Kosove	120,000.00
Sherbimet Kulturore - Fushe Kosove	85002	820	22	30	50775	Ndertimi i fushkave simetrike ne fshatin Bardh i Madh	187,544.81
Sherbimet Kulturore - Fushe Kosove	85002	820	22	30	51356	Palestra sportive ne Silatin e vogel	500,000.00
Administrata Arsim - Fushe Kosove	92010	900	22	30	44923	Ndertimi i shkolles fillore ne Fushe Kosove	225,862.10

Totali : 2,843,660.56